


Tani, falë punës së të gjithë profetëve të shenjtë (Abrahamit, Moisiut, Krishtit, Budës, Krishtit, Muhametit, Babi-t dhe Bahá'u'lláh-ut), njeriu ka arritur atë shkallë zhvillimi, në të cilën ai është gati për një mësim universal. Ky mësim do t'i zhdukë të gjitha kundërshtitë e mëparshme dhe do t'i pajtojë të gjitha sektet e ndarjet fetare në të cilat është përcarë njerëzimi. Ky mësim universal do të vendosë epokën e "Paqes mbi Tokë për të gjithë njerëzit me vullnet të mirë", ardhjen e së cilës e kanë parashikuar të gjithë profetët në librat e shenjtë.

Shumë shpikje të reja si komunikimi elektronik (telefoni, radioja, faksi, sateliti etj.), transporti shumë i shpejtë (trenat, aeroplanët reaktivë, makinat etj.), informatika (super dhe mini kompjuterat, ruajtja e informacionit në disqe optikë etj.), ndihmojnë bashkimin e njerëzimit, por vetëm këto gjëra nuk mund ta sjellin bashkimin. Duhet ndryshimi i shpirtit, të cilin mund ta përmbushë vetëm ky mësim universal.

Sa herë që një profet ose një lajmëtar i Perëndisë sjell lajmin e ri hyjnor, nis një periudhë e re Bahá'u'lláh-ut, vjen si profeti i periudhës së re në të cilën po hyn njerëzimi. Ai përmbush zotimet e lajmëtarëve hyjnorë të mëparshëm dhe përtërin veprat e tyre.



Hifa

Fjalë të Bahá'u'lláh-ut

O BIR I SHPIRITIT!

Këshilla Ime e parë është kjo: ki një zemër të delirë, të sjellshme e rrëzëluese, që yti të jetë një sovranitet i lashtë, i pavdekshëm e i përjetshëm.

O bir i shpirtit!


Më e shumëdashura e të gjitha gjërave në sytë e Mi është drejtësia; mos u largo prej saj, nëse më do Mua, dhe mos e lër atë pasdore, që Unë të kem besim tek ti. Me ndihmën e saj ti do të shikosh me sytë e tu e jo me sytë e të tjerëve, dhe do të dish me dijen tënde e jo me dijen e fqinjit tënd. Peshoje këtë në zemrën tënde; kështu të ka hije të jesh. Me të vërtetë drejtësia është dhurata Ime për ty dhe shenja e dashamirësisë Sime. Mbaje, pra, këtë para syve të tu.

O shok i fronit Tim!

Mos dëgjo e mos shih asnjë të keqe, mos e poshtëro veten, as mos psherëti e vajto. Mos fol keq, që të mos dëgjosh të flasin keq për ty, dhe mos i zmadho të metat e të tjerëve, që të mos duken të mëdha të metat e tua; mos dëshuro poshtërimin e askujt, që të mos dalë në shesh poshtërimi yt. Jetoji, pra, ditët e jetës sate, që janë më të shkurtëra sesa një çast kalimtar, me mendje të pastër, me zemër të panjollë, me mendime të kulluara dhe me karakter të shenjtëruar, në mënyrë që, i lirë e i kënaqur, të flakësh tujë këtë trup të vdekshëm dhe të shkosh në parajsën mistike e të jetosh përgjithmonë në mbretërinë e përjetshme.

Lutje për unitet

O Perëndia im! O Perëndia im! Bashkëj zemrat e shërbëtorëve të Tu dhe zbuloj u atyre qëllimin Tënd të madh. Zbatofshin ata porositë e Tua dhe iu bindshin ligjit Tënd. Ndihmoji ata, O Perëndi, në përpjekjen e tyre dhe jepu fuqi të të shërbejnë Ty. O Perëndi! Mos i lër ata me vetveten, por drejtoji hapat e tyre me dritën e dijes Tënde, dhe gëzoji zemrat e tyre me dashurinë Tënde. Me të vërtetë, Ti je Përkrahësi i tyre dhe Zoti i tyre.



Bahá'í House of Worship, Wilmette, U.S.A.

BESIMI BAHÁ'Í

Ai ka për qëllim vendosjen e një Feje Botërore dhe të paqes së përgjithshme midis popujve. Ka nisur në Iran nga mesi i shekullit XIX dhe po përhapet me shpejtësi, jo vetëm në vendlindjen e vet, por në të katër anët e botës, si në Lindje dhe në Perëndim.

Cilat janë parimet e tij?

Më kryesoret janë:

- Ekziston vetëm një Perëndi, Burimi dhe Krijuesi i gjithçkaje.
- Uniteti i njerëzimit: të gjithë njerëzit janë si "gjethet e një peme, lulët e një kopshti".
- Të gjitha fetë janë një në parimet themelore të tyre. Feja duhet të sjellë dashuri, ndryshe s'është fe.
- Kërkimi i pavarur i së vërtetës, çlirimi nga paragjykimet e tradita.
- Feja duhet të ecë krah për krah me shkencën, besimi dhe mendja duhet të bashkëjetojnë në harmoni.
- Vendosja e Unitetit dhe e Paqes së përgjithshme botërore, krijimi i një lidhjeje ndërkombëtare dhe i një kuvendi ndërkombëtar.
- Zgjedhja ose krijimi i një gjuhe ndërkombëtare, e cila duhet të mësohet në të gjitha shkollat e botës.
- Arsimi i detyruar, sidomos për vajzat, që do të bëhen nënat dhe mësueset e para të brezit të ri.

The Bahá'í Faith

www.bahai.org/national • 1-800-22UNITE

The Bahá'í House of Worship

100 Linden Ave., Wilmette, IL 60091

how@usbnc.org • www.bahaitemple.org

(847) 853-2300

Albanian

- Barazia e plotë e dy seksëve në të gjitha deçytrat dhe të drejtat.
- Të gjithë duhet të punojnë: as përtaç i pasur, as përtaç i varfër, sepse puna në kufirin e shërbitimit është adhurim i Perëndisë.
- Ka një bazë shpirtërore për zgjidhjen e problemeve ekonomike.
- Qëllimi i njerëzimit është të çojë përpara një qytetërim gjithnjë e më të zhvilluar.

Si doli në dritë?


Pararendësi i tij që një burrë i ri i njohur si Bâb-i (Porta). Në vitin 1844 filloi të predikonte ardhjen e një më të madhi se Ai vetë, prej të Cilit do të niste një periudhë e re për fenë dhe për qytetërimin. Themeluesi që Bahá'u'lláh-u (Lavdia e Perëndisë), i Cili më 1863 përcaktoi parimet e Besimit dhe shpalli se ishte Ai njeriu për ardhjen e të Cilit kishin profetizuar Bâb-i dhe të gjithë profetët e tjerë. Vendi i fundit i burgimit që 'Akká, në Palestinë, ku edhe ndërroi jetë më 1892.

Shpjeguesi dhe përhapësi i shkrimeve e parimeve të Tij ishte 'Abdu'l-Bahá-i (Shërbëtori i Bahá-it), djali i Tij, tek i Cili duhej të drejtoheshin të gjithë Bahá'í-të për mësim e udhëheqje. 'Abdu'l-Bahá-i ishte shok i ngushtë e ndihmës besnik i të atit, ndau me Të të gjitha hidhërimet. Qëndroi në burg deri në vitin 1908, kur qeveria e vjetër e Turqisë u përmbys dhe qeveria e re i liroi të burgosurit për shkaqe politike ose fetare. 'Abdu'l-Bahá-i vazhdoi të banonte në Palestinë, por ndërmori udhëtime të gjata mësimi në Egjipt, Evropë dhe Amerikë, ku u shpjegoi miqve e pasuesve parimet e Besimit Bahá'í.

Ndërroi jetë më 1921, kur ishte shtatëdhjetë e pesë vjeç, dhe në Testamentin e Vet kishte caktuar të nipin, Shoghi Effendi-un, si Ruajtës të Besimit. Ai la edhe udhëzime për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të një Keshilli Ndërkombëtar për të udhëhequr zhvillimin e Besimit dhe për të bashkëvenduar përpjekjet e pasuesve të tij në përpunje me parimet e Bahá'u'lláh-it.

Ç'ka përmbushur?


Kur Bâb-i dhe Bahá'u'lláh-u bënë Deklarimin e tyre, situata politike e Iranit ishte shumë e keqe. Fanatizmi fetar ishte i pamatsëm. Qeveria ishte e dobët, por përmëdhejtë ishin të shumta; shkenca dhe arti përëndimor konsideroheshin të papasura. Gratë mbaheshin në injorancë e të mbyllura. Që në fillim qeveria përdoqi besimtarët Bâb-i apo Bahá'í; rreth 20.000 veta vdiqën si martirë. Numri i atyre që qeveria burgosi, trahu ose grabiti dhe i atyre që morën arratinë, që edhe më i madh. Njerëz me prejardhje fetare të ndryshme, që më parë urrenin e përçmonin njëri-tjetrin, u bashkuan në një vëllazëri të madhe dhe ishin gati të ndihmonin njëri-tjetrin. Këta njerëz hodhën poshtë paragjykimet e veta, ngritën shkolla në çdo fshat, mësuuan vajzat e tyre, u bënë tolerantë e përparimtarë. Në llogarjen e numrit të anëtarëve të lëvizjes në Iran, Lordi Kurzon i Kedlestonit në librin e vet "Persia", që doli më 1892, shkruan: "Në vendet e përmentura numri i tyre sot është gjysmë milioni, nga bisedimet me njerëz të kualifikuar, kam llogaritur rreth një milion".



Selia e Shërbësit Universal të Drejtësisë

Në Rusi, Amerikë, Indi, Birmani dhe Gjermani, besimtarët Bahá'í numërohen me mijëra, kurse gindra e gindra janë duke u shtuar me shpejtësi në shumë vende të Evropës, në Kinë, Japoni, Australi, në Zelandën e Re, Afrikën e Jugut, në ishujt e Oqeanit Paqësor e kudo në botë. Të krishterë, hebrej, myslimanë, zoroastrianë, hindu, njerëz prej çdo feje ose

që më parë nuk besonin, po bashkohen në këtë vëllazëri të madhe duke braktisur paragjykimet e vjetra e të këqija, si dhe të gjitha mëritë. Ata bashkohen në veprimtaritë dhe zotohen për ardhjen e Mbretërisë së Perëndisë mbi Tokë.



Bahá'í House of Worship, Wilmette, U.S.A.

Besimi Bahá'í e ka treguar forcën e vet, sepse ai ka ndryshuar zemrat dhe jetën e njerëzve, duke i bërë ata krijesa të reja. Ai ka një bazë të fortë në të cilën njerëz prej çdo feje, race, kombi e pozite shoqërore po bashkohen në një familje të madhe e të harmonishme.

Ky Besim ka zbuluar mjetet me të cilat mund të ndërtohet një qytetërim i ri dhe bashkëpunimi të zërtë vendin e kundërvënies, miqësia vendin e armiqësisë dhe nënshtrimi ndaj vullnetit të Perëndisë vendin e egoizmit e të dëshirave të kësaj bote.

Cili është raporti i Besimit Bahá'í me Besimet e tjera të botës?

Bahá'u'lláh-u mëson se të gjitha besimet janë pjesët të një plani hyjnor për edukimin dhe shpëtimin e njerëzimit. Të gjithë profetët dhe fethemeluesit e mëdhenj kanë predikuar një fe, e cila qëndron në lujten e në shërbimin ndaj një Perëndie të vetëm, por secili e ka paraqitur mësimin e tij në formën që kuptohet më mirë për kohën dhe popullin e vet. Kurrë nuk ka pasur mungesë harmonie midis profetëve; janë pasuesit e tyre të verbër që kanë rënë në mosmarrëveshje.